



Autoriteti kontraktues **Komuna e Fushë-Kosovës**, përmes Drjetorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedis në mbështetje të Ligjit Nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor, Rregullores Nr. 160/2013 për Transportin Rrugor në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, si dhe akteve të tjera në fuqi që rregullojnë transportin publik të udhëtarëve shpall:

SHPALLJE PUBLIKE

Për përzgjedhjen e operatorit të transportit rrugor për kryerjen e transportit të rregullt publik të udhëtarëve në linjën urbano-periferike:

RELACIONI I LINJËS:

Graboc i Epërm – Graboc i Poshtëm – Bardh i Madh – Lismir – Nakarad – Prishtinë dhe anasjelltas.

Linja do të operojë në të dy drejtimet, sipas rendit të udhëtimit të miratuar nga organi kompetent.

LLOJI I TRANSPORTIT

Transport i rregullt publik i udhëtarëve në linjë urbano-periferike, i cili do të kryhet me automjete të përshtatshme për transportin e udhëtarëve me kapacitet së paku **8 -20 ulëse** fabrikisht, të cilat duhet t'i plotësojnë të gjitha kushtet teknike, të sigurisë, higjienike dhe të tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

QËLLIMI I SHPALLJES

Qëllimi i kësaj shpalljeje është sigurimi i ofrimit të rregullt, të sigurt, cilësor dhe të pandërprerë të transportit publik për banorët e vendbanimeve të përfshira në relacionin e lartcekur, si dhe lidhja e tyre me qytetin.

KUSHTET QË DUHET T'I PLOTËSOJË OPERATORI

Të drejtë aplikimi kanë operatorët ekonomikë/personat juridikë ose fizikë të cilët janë të regjistruar dhe të licencuar për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve dhe që i plotësojnë kushtet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Operatori duhet të dëshmojë së paku:

1. Aplikacionin i cili duhet të përmbajë emrin, selinë, adresën nr. e telefonit të kompanisë si dhe dëshmia mbi fletëpagesën e aplikimit që merret në zyrën pritëse;
2. Çertifikatën mbi regjistrimin e biznesit në Kosovë;
3. Dëshminë që ka në pronësi ose me qera zyrën administrative dhe parkingun;
4. Dëshminë e lëshuar nga gjykata se operatori ekonomik si person juridik dhe menaxheri i tij (menaxheri i operatorit) si person fizik nuk kanë pengesa ligjore të zhvilloi veprimtarinë në lëmin e transportit;

5. Dëshmi se automjeti/automjetet i plotësojnë kushtet teknike me çertifikatën e kontrollit teknik jo më të vjetër se 6 muaj;
6. Automjeti me të cilin bëhet transporti rrugor i udhëtarëve në trafiku urban duhet ti plotësoj kushtet teknike dhe tekniko – shfrytëzuese të rregullsisë së automjeteve;
7. Çertifikatën e vendbanimit (Banor i Komunës së Fushë Kosovës);
8. Çertifikatën mjekësore;
9. Letrnjoftimi kopje;

RENDI I UDHËTIMIT

Rendi i udhëtimit është akt me të cilin përcaktohen elementet për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor, andaj operatori i përzgjedhur do ta realizojë transportin sipas rendit të udhëtimit të miratuar nga Komuna, i cili do të përmban:

- Emrin e transportuesit;
- Relacionin;
- Llojin e transportit;
- Radhitjen e vend – ndaljeve dhe largësinë e tyre nga pika fillestare;
- Kohën e nisjes dhe kohën e arritjes në çdo stacion dhe vend -ndalje;
- Periudha kohore në të cilën mbahet linja;
- Afatin e vlefshmërisë së rendit të udhëtimit;
- Rendi i udhëtimit nuk mund të tjetërsohet as të jepet me qira;
- Transferimin e rendit të udhëtimit e bënë vetëm Drejtoria për Shërbime Publike dhe Mjedis;
- Emri i operatorit transportues të shënuar në rendin e udhëtimit duhet të jetë i njëjtë me atë të shënuar në librezën e qarkullimit të autobusit dhe dokumenteve tjera përcjellëse të autobusit;
- Rendet e udhëtimit që lëshohen nga organi përgjegjës komunal.

TARIFA E TRANSPORTIT

Transporti do të realizohet sipas tarifës së miratuar nga organi kompetent i Komunës.

Operatori është i obliguar që tarifën e miratuar ta zbatojë në mënyrë të njëjtë për të gjithë udhëtarët dhe të pajisë udhëtarët me biletë/dëshmi të pagesës, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

OBLIGIMET E OPERATORIT

Operatori i përzgjedhur obligohet:

- që transportin ta kryen sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi dhe rregullores komunale;
- që të shfrytëzoj stacionet e autobusëve që janë të licencuar nga Ministria dhe vendndaljet të cilat janë të sinjalizuara me shenja horizontale dhe vertikale dhe të dedikuara për transport ndër - urban;
- të mos ndërpresë linjën pa autorizimin e organit kompetent;
- të respektojë të gjitha vendndaljet e përcaktuara;
- të mos transportojë numër më të madh të udhëtarëve se sa kapaciteti i lejuar i automjetit i përcaktuar në librezën e qarkullimit;
- të sigurojë mirëmbajtjen dhe pastërtinë e automjetit;
- të respektojë legjislacionin për sigurinë në komunikacion dhe transportin publik;
- të respektojë çmimorën dhe kushtet e përcaktuara nga Komuna;
- të mbajë evidencat e kërkuara për udhëtimet dhe udhëtarët;

- t'u nënshtrohet kontrolleve nga organet kompetente të Komunës dhe organet e tjera të autorizuar.

KRITERET E PËRZGJEDHJES

Përzgjedhja e operatorit do të bëhet nga Komisioni i themeluar nga organi kompetent i Komunës, në bazë të kriterëve të përcaktuara në dokumentacionin e kësaj shpalljeje.

Kriteret e përzgjedhjes do të përfshijnë, sipas rastit:

1. Përbushjen e kushteve ligjore dhe administrative;
2. Kapacitetin dhe përshtatshmërinë e automjetit;
3. Përvojën në ushtrimin e veprimtarisë së transportit publik;
4. Kapacitetin profesional dhe teknik;
5. Elemente të tjera të përcaktuara në dokumentacionin e shpalljes.

MËNYRA DHE AFATI I APLIKIMIT

Aplikimi dorëzohet në zyrën pritëse - Komuna e Fushë-Kosovës;

Adresa: Rruga **"Tahir Zemaj"** Nr. 1

Afati për dorëzimin e aplikacioneve është **15 ditë** nga dita e publikimit të kësaj shpalljeje.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

DOKUMENTACIONI

Aplikuesi duhet të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar sipas kësaj shpalljeje dhe dokumentacionit përcjellës, në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga Komuna.

Dokumentet duhet të jenë të vlefshme në momentin e aplikimit.

INFORMATA SHITESË

Të gjithë operatorët e interesuar mund të marrin informata shtesë lidhur me linjën, itinerarin, vendndaljet, orarin, kriteret dhe dokumentacionin e kërkuar në:

Komuna e Fushë-Kosovës – [Drejtoria për Shërbime Publike dhe Mjedis]

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Komuna e Fushë-Kosovës rezervon të drejtën që, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe interesin publik, të anulojë, ndryshojë ose përshtatë procedurën e përzgjedhjes, nëse paraqiten rrethana ligjore apo faktike që e arsyetojnë një veprim të tillë.

Për çështjet që nuk janë të përcaktuara shprehimisht me këtë shpallje zbatohen dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor, ndryshimet dhe plotësimet e tij, aktet nënligjore përkatëse dhe aktet komunale në fuqi dhe Rregullorja komunale për Transportin Rrugor në territorin e komunës së F.Kosovës Nr. 28 të datës 10.02.2020.

Fushë - Kosovë: 31.08.2026

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Mjedis

Izja Mjeku – Drejtor

